



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA E AUDITORIT GJENERAL/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit. 22.24.1-2007-08

RAPORTI FINAL I AUDITIMIT

MBI PASQYRAT FINANCIARE TË KOMUNËS SË VUSHTRRIË

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2007

Prishtinë, Tetor 2008

TABELA E PËRMBAJTJES

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hytje
- III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga viti i kaluar
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Opinioni i auditimit
- VI. Qasja e auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Aneks:

- I. Pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007

Lista e shkurtesave

AGJ	Auditori Gjeneral
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
K K V	Kuvendi Komunal Vushtrri
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
NJ A B	Njësia e Auditimit të Brendshëm
ZAGJ	Zyra e Auditorit Gjeneral
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit Gjeneral (ZAGJ) ka kryer auditimin e Pasqyrave financiare të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare nuk paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të Komunës së Vushtrrisë deri më 31 dhjetor 2007 dhe rezultatet e aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik sipas “Raportimit financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe përfshinë testimet dhe procedurat e tilla që ne i kemi konsideruar të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Auditimi i pasqyrave financiare ka identifikuar dobësitë në këto fusha vijuese që duhet të adresohen menjëherë për ta përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e organizatës.

1. Pasqyrat financiare
2. Menaxhimi i Pasurive
3. Të hyrat
4. Pagesat për shëndetësi
5. Taksat për shkollim joformal
6. Paga dhe mëditje
7. Mallra dhe shërbime
8. Investimet kapitale - Prokurimi
9. Kontrolli i brendshëm
10. Auditimi i brendshëm

Katërbëdhjetë rekomandimet tona kanë synim adresimin e dobësive të identifikuara dhe përmirësimin e mjedisit financiar dhe operativ të komunës.

II. Hyrje

♦ Zyra e Auditorit të Përgjithshëm funksionon në bazë të Ligjit nr. 03/L-075 . According to Article 3.2 of the Laë, the Auditor-General (AG) shall annually conduct a Regularity Audit of the Kosova Consolidated Budget , organizatave buxhetore, duke përfshirë por pa u kufizuar; Kuvendin e Republikës së Kosovës, Zyrën e Presidentit të Kosovës, të gjitha ministritë ose agjencitë ekzekutive, komunitet, organet e pavarura, Bankën Qendrore dhe subjektet tjera të cilat janë me më shumë se 50% në pronësi publike ose marrin mjete financiare nga Fondi i Konsoliduar i Kosovës, sigurojnë dividatat apo të ardhurat tjera të pataksueshme, duke përfshirë por pa u kufizuar: Shërbimin Doganor të Kosovës, Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Ombudspersonin.

Sipas nenit 1 (përkufizimet) të këtij Ligji Auditimi i Rregullsisë përkufizohet si verifikim i përgjegjësive financiare, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtuar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Bazuar në nenin 47.1 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë - Auditori i Përgjithshëm do të përgatisë dhe t'i dorëzojë Kuvendit një raport mbi deklaratat financiare të organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike për vitin e kaluar fiskal. Nëse organizata buxhetore është komunë, raporti po ashtu duhet t'i sigurohet kuvendit komunal. Ky raport do të parashtrijë opinionet e Auditorit të Përgjithshëm mbi atë se nëse deklaratat financiare të organizatave të këtilla buxhetore japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë të financave të këtyre organizatave buxhetore dhe ndërmarrjeve publike.

Sipas nenit 3.3 të Ligjit nr. 03/L-075 për themelimin e ZAP, Auditori i Përgjithshëm i siguron Kuvendit të Kosovës raportin për auditimin e rregullsisë së Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës jo më vonë se deri më 31 gusht të vitit pas periudhës së auditimit.

III. Gjendja lidhur me rekomandimet nga vitet e kaluara

Raporti ynë i auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2006 përfshinë 14 rekomandime nga të cilat 5 janë zbatuar vetëm pjesërisht.

Dështimi për zbatimin plotë të rekomandimeve tona është një shqetësim me arsye dhe një tregues i fortë që dobësitë e raportuara më parë ekzistojnë ende.

IV. Fushëveprimi i auditimit

ZAGJ ka bërë auditimin e pasqyrave financiare të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2007.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t'i mundësohet ZAGJ-it të shprehë opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të K.K të Vushtrrisë, të paraqitura në aneksin 1, japin një pasqyrë të vërtetë dhe të drejtë e të hyrave të arkëtuara dhe shpenzimeve të bëra gjatë vitit të përfunduar më 31 Dhjetor 2007, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) mbi "Raportimin Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".

SNKSP-të nxirren nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (BSNASP) i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK). Saktësia dhe plotësia e pasqyrave financiare si dhe shkresave shoqëruese të dhëna në aneksin 1, janë përgjegjësi e Menaxhmentit.

V. Opinioni i auditimit

Për mendimin tonë pasqyrat financiare të hartuara nga K.K të Vushtrrisë. dhe të prezantuara në Aneksin I nuk paraqesin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozitës financiare të K.K. të Vushtrrisë deri më 31 dhjetor 2007 dhe rezultatet e aktiviteteve të saja për vitin në fjalë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik sipas "Raportimit financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme".

Testimi përmbajtjesor ka shpalosur keqdeklarimet dhe gabime materiale që ndikojnë në pasqyrat financiare. Në disa raste, K.K. i Vushtrrisë nuk ka respektuar ligjet dhe rregulloret në fuqi, të cilat po ashtu ndikojnë negativisht në saktësinë dhe plotësinë e pasqyrave financiare. Së fundi, K.K. i Vushtrrisë nuk i ka përgatitur pasqyrat financiare në pajtim me SNKSP-të.

Dobësitë e mëdha të kontrollit të brendshëm dhe rastet e mosrespektimit të kërkesave ligjore do të paraqiten në Pjesën VII të këtij Raporti.

VI. Qasja e auditimit

Auditimi ynë i pasqyrave financiare të K.K të Vushtrrisë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2007 është kryer në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit dhe Sigurisë. Bordi funksionon si një organ përcaktues për standardet ndërkombëtare, nën patronazhin e FNK-së. SNA-të vendosin kornizën ndërkombëtare në kuadër të cilës ZAGJ kryen aktivitetin e saj dhe mbulon çështjet si: parimet dhe përgjegjësitë e përgjithshme, vlerësimi i rreziqeve dhe përgjigjet ndaj rreziqeve të vlerësuara, dëshmia e auditimit, mbështetja në punën e të tjerëve si dhe konkluzionet dhe raportimi mbi auditimin.

Auditimi ynë është kryer në periudhën prej 07.07.2008 deri më 29.07.2008. Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësisive tona, ne:

- Kemi rishikuar pasqyrat financiare të K.K të Vushtrrisë në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2007;
- Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të K.K të Vushtrrisë janë përgatitur në pajtim me SNKSP-të “ Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi kryer testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
- Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të komunës, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;
- Kemi ekzaminuar menaxhimin e pasurive fikse për të verifikuar përputhshmërinë me rregulloren mbi pasuritë qeveritare.

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin dhe informatat e tjera të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit. Ka të ngjarë që informata shtesë mund të kenë ekzistuar, të cilat nuk na janë siguruar neve, e të cilat po të na siguroheshin do të kishin mundur të ndryshonin të gjeturat tona të auditimit.

Për sa i përket opinionit të auditimit të ZAGJ-it lidhur me pasqyrat financiare të K.K të Vushtrrisë, SNA-të definojnë kriteret specifike të cilat përcaktojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit. Për shembull, ZAGJ mund të mos jetë në gjendje të japë një opinion të pakualifikuar kur ekzistojnë cilado prej rrethanave vijuese dhe sipas gjykimit të ZAGJ-it efekti i çështjes është ose mund të jetë material për pasqyrat financiare:

(a) Kur ka kufizim të fushëveprimit të punës së auditorit; ose

(b) Kur ka mosmarrëveshje me menaxhmentin lidhur me pranueshmërinë e politikave të zgjedhura kontabël, metodën e aplikimit të tyre ose përshtatshmërinë e shpalosjeve të pasqyrave financiare.

Rrethanat e përshkruara nën (a) mund të shprijnë në opinionin e kualifikuar ose në mohimin e opinionit. Rrethanat e përshkruara nën (b) mund të shprijnë në opinionin e kualifikuar ose në opinionin kundërt.

Një opinion i kualifikuar në përgjithësi lëshohet atëherë kur ZAGJ konstaton se nuk mund të jepet një opinion i pakualifikuar, porse efekti i ndonjë mosmarrëveshjeve me menaxhmentin ose kufizimi i fushëveprimit nuk është aq material dhe i përhapur sa të kërkojë dhënien e një opinionit të kundërt ose mohim të opinionit.

Mohim i opinionit do të jepet atëherë kur efekti i mundshëm i kufizimit në fushëveprim është aq material dhe i përhapur sa që ZAGJ nuk ka mundur të sigurojë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit dhe rrjedhimisht nuk mund të lëshojë opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Një opinion i kundërt do të jepet atëherë kur efekti i mosmarrëveshjes është aq material dhe i përhapur në pasqyrat financiare për çka dhe ZAGJ konstaton se kualifikimi i raportit nuk është i përshtatshëm për të shpalosur natyrën e çorientuar ose jo të plotë të pasqyrave financiare.

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

1. Pasqyrat financiare

Pasqyrat financiare duhet të përgatiten nga secili entitet i pavarur duke u bazuar në regjistrat e tyre kontabël dhe në atë mënyrë që pasqyrat të demonstrojnë llogaridhënie dhe transparencë në shpenzimin e parasë publike. Format i tyre kërkon shpalosje shtesë për të siguruar informata shtesë për të interesuarit.

Ligji nr. 2003/2 “ Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë” rregullon përgatitjen dhe harmonizimin e pasqyrave financiare për të gjitha organizatat buxhetore.

Për të qenë në pajtim me Ligjin nr. 2003/2 kërkohet që:

- Zyrtari kryesor financiar i organizatës buxhetore brenda 30 ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal do t’ia dorëzojë drejtorit të Thesarit (i) kopjen e pasqyrave financiare (ii) konfirmimin që pasqyrat financiare paraqesin drejtë dhe saktë financat dhe transaksionet financiare të vitit.
- Drejtori i Thesarit brenda 90 ditësh pas përfundimit të çdo viti fiskal do të (i) harmonizojë llogaritë financiare me llogaritë fiskale dhe bilancet e parave të gatshme dhe (ii) dorëzojë llogaritë financiare për të gjitha organizatat buxhetore tek Auditori Gjeneral për auditim.

Këto pasqyra financiare duhet të përgatiten sipas shënimeve të kontabilitetit që duhet të mbahen nga çdo organizatë buxhetore siç është përkufizuar me Ligjin nr. 2003/2 si në vijim:

- Arkëtimet e organizatës buxhetore
- Detyrimet e papaguara të organizatës buxhetore
- Pasuritë e organizatës buxhetore
- Ndarjet buxhetore
- Rregullimet e ndarjeve buxhetore
- Ndarjet që janë vënë në dispozicion për organizatën buxhetore për shpenzim përmes njoftimeve për alokimin e mjeteve

- Niveli në të cilin mjetet e alokuara të organizatës buxhetore janë regjistruar si mjete të zotuar
- Shpenzimet tashmë të realizuara.

Pasqyrat financiare duhet të përgatiten në pajtim me Udhëzimin Administrativ 2007/08 i cili udhëzon lidhur me politikat e raportimit dhe përshkrimin e detyrimeve të raportimit për paraqitjen në pasqyrat financiare të çdo organizate buxhetore.

Ky udhëzim në pjesën nr. 16 thekson – shpalosjet e shënimeve për pasurit jo-financiare, ku çdo organizatë duhet të ofrojë shënime financiare lidhur me pasuritë e tyre themelore.

Të gjeturat

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare për vitin 2007 janë të pasakta dhe të pabesueshme meqë përmbajnë shënime jo të plota për të hyrat dhe pasuritë në fund të vitit. Ne i raportojmë të gjeturat tona lidhur me të hyrat në një pjesë të veçantë të këtij raporti.

Komentet e Komunës

Pasi që kemi shqyrtuar dhe analizuar draft raportin mbi pasqyrat financiare, duke ju falënderuar për punën e bërë kemi ardhur në përfundim se raporti përmban një material të mirë dhe këshillëdhënës mirëpo kemi disa vërejtje dhe mospajtime lidhur me disa nga pikat e këtij raporti.

Që në fillim kishim një vërejtje gjeneralë në mënyrën e formulimit të tekstit të shkruar e që në fakt nuk ka të bëjë me realitetin e gjendjes faktike.

Që në fillim konstatojmë se pasqyrat financiare të Komunës së Vushtrrisë janë hartuar-punuar në bazë të Udhëzimit Administrativ 2007/08 të nënshkruara nga drejtori i thesarit z.Lulzim Ismaili dhe zëvendës drejtori i thesarit z.Zilif Lufi, për ju është e ditur se ky udhëzim jep shpjegime dhe obligime në bazë të të cilave çdo organizatë buxhetore duhet ti përgatis pasqyrat financiare dhe pa plotësimin dhe barazimin e të gjitha tabelave në kuadër të pasqyrave financiare sipas udhëzimit të cekur më lartë, raportimi në MEF-Departamenti i thesarit nuk është i pranuar.

Të gjitha tabelat në kuadër të raportimit financiar e kanë edhe shtojcën që në bazë të shkrimeve të juaja mendojmë se nuk ka qenë e mjaftueshme, mirëpo ne jemi në gjendje të ofrojmë shpalosje tjera nëse ju e konsideroni të nevojshme dhe të arsyeshme sepse secila tabelë e ka pjesën shtojcë që sqaron prejardhjen e të dhënave.

Në fund të këtij konstatimi ofrojmë shkresën e pranimit të pasqyrave financiare nga ana e thesarit për Komunën e Vushtrrisë që do të thotë se shënimet e ofruara janë në pajtim me Ligjin mbi Menaxhimin e Financave dhe Përgjegjësit Publike nr.2003/2 dhe udhëzimin administrativ 2007/08.

Në vazhdim do të nisemi nga kreu 7 të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit ZKF duke u mbështetur në ligjin LMFPP ka përmbush obligimin dhe në afatin prej 30 ditësh pas përfundimit të vitit fiskal ka dorëzuar pasqyrat financiare në MEF-Dep. I thesarit dhe njëherit është bërë barazimi i të dhënave më të dhënat nga libri kryesor i thesarit e njëherit shënimet (pasqyrat financiare) të Komunës së Vushtrrisë janë barazuar në kontabilitetin e mbajtur nga ana e komunës gjithashtu në pajtim me ligjin LMFPP për çka ekziston edhe shkresa për barazimin e të dhënave.

Përgjigja e ZAGJ-së ndaj komenteve

Të gjeturat e raportuara bazohen në dëshmi të mbledhura gjatë auditmit tonë të cilat tregojnë jo plotësinë dhe jo saktësinë e PF të Komunës për vitin 2007 meqenëse këto të dhëna nuk kanë mbështetjen e plotë në dokumentet burimore. Komentet e Komunës nuk ofrojnë dëshmi relevante dhe të mjaftueshme për të vërtetuar të kundërtën. Prandaj të gjeturat dhe rekomandimet mbeten të pandryshuara.

2. Menaxhimi i pasurisë

Udhëzimin Administrativ nr. 2005/11 i lëshuar nga Departamenti i Thesarit i cili rregullon Menaxhimin dhe Regjistrimin e Pasurive Qeveritare bazohet në Ligjin 2003/2- Menaxhimi i Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Kjo kornizë rregullative është vendosur për të siguruar që mjetet publike janë drejtuar, regjistruar dhe ruajtur si duhet për ta minimizuar rrezikun ndaj mashtrimit, keqpërdorimit dhe shpërdorimit.

Të gjeturat

Komuna nuk e ka azhurnuar regjistrin e pasurive themelore këtë vit, dhe nuk ishte bërë inventarizim vjetor të pasurive.

Konkluzion

Pa një regjistër të saktë dhe të azhurnuar të pasurive themelore, komuna nuk ishte në gjendje të kontrollojë dhe të menaxhojë si duhet pasuritë e saj, duke e rritur rrezikun ndaj mashtrimit, keqpërdorimit dhe shpërdorimit. Ky dështim ka rezultuar me mos-shpalosjen e shënimeve në pasqyrat financiare siç kërkohet me UA 2007/08.

Rekomandimi 1

Komuna duhet:

- T'i përmbahet udhëzimit administrativ të MEF-it dhe të caktojë zyrtarin e pasurive dhe në përgjithësi të sigurojë një strukturë adekuate të kontrollit të brendshëm të pasurive;
- Që menjëherë të regjistrojë të dhënat për të gjitha pasuritë themelore në pajtim me Udhëzimit Administrativ 2005/11;
- Të përgatisë dhe të lëshojë një raport lidhur me pasuritë e komunës siç kërkohet me UA 2007/08.

Komentet e Komunës

Menaxhimi i pasurisë, zyrtari për regjistrimin e pasurisë ka sjell materialin e nevojshëm andaj kërkohet mirëkuptim që të njëjtin ta analizoni dhe të sillni konstatimin dhe rekomandimin adekuat.

Përgjigja e ZAGJ-se ndaj komentit

Ne vlerësojmë se raporti i sjellur nga komuna nuk ofron prova të mjaftueshme dhe bindëse se Komuna kishte bërë inventarizimin e pasurisë së vet në mënyrë të rregulltë dhe brenda kohës së kërkuar për vitin 2007. Prandaj konkluzionet dhe rekomandimet e auditimit mbeten të njëjta.

3. Të hyrat

Të hyrat e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2007 janë analizuar në tabelën nr. 1:

Tabela nr. 1

Klasifikimi i të Hyrave	Fundi vitit 31 Dhjetor 2007
	(në Euro)
Të hyrat vetjake të Komunës	851,723
Grandet e Qeverisjes Qendrore	4,964,952
Grandet e Përcaktuara të brendshme	231,517
Grandet e Përcaktuara të donatorëve	10,489
Të Hyrat e vitit 2007	6,058,681
të bartura nga viti 2006 për 2007	466,369
Totali i të Hyrave	6,525,050

Gjatë auditimit ne kemi identifikuar transaksionet të cilat kanë ndikuar në saktësinë dhe plotësinë e raportimit të hyrave. Këto janë raportuar ndaras.

3.1 Regjistrimit kontabël- Regjistrimi dhe raportimi i të hyrave

Keqdeklarimet e bilanceve kontabël ose të shpalosjeve drejtpërdrejtë ndikojnë në paraqitjen e pasqyrave financiare dhe mund të shpijnë në humbjen dhe keqpërdorimin e pasurive.

Të gjeturat

Ne raportojmë një diferencë prej 5,522€ ndërmjet bilanceve të hyrave vetjake në fund të vitit në sistemin “Free Balance” dhe pasqyrave financiare. Ne nuk kemi marrë ndonjë shpjegim nga komuna lidhur me këtë diferencë.

Komenti i Komunës

Auditorët kanë vërejtur një diferencë në të hyrat vetjake prej 5.522 euro ndërmjet bilancit të të hyrave në fund të vitit sipas sistemit të Free Balancit dhe pasqyrave financiare lidhur me këtë ju njoftojmë se komuna ka dhënë sqarimin e kësaj diferencë në afatin e parapare dhe të njëjtin sqarim e kemi dërguar në ZAGJ, andaj ndryshimi i cekur më lartë është pasoje e një gabimi të vogël teknik

i cili gjate regjistrimit te shënimeve ka kaluar nga buxheti me rishikim ne buxhetin përfundimtarë.

Përgjigja e ZAGJ-së ndaj komentit

Ne kemi diskutuar këtë diferencë më menaxhmentin e komunës gjatë kohës së auditimit për çka nuk kemi marrë asnjëherë sqarime të duhura. Derisa komentet e komunës nuk mbështeten në dëshmi të mjaftueshme sa për të ndryshuar të gjeturën audituese të paraqitur në raport. Prandaj konkluzionet dhe rekomandimet mbesin te pandryshuara.

Vazhdim i të gjeturave

Për më tepër, ne kemi identifikuar gabimet gjatë regjistrimit të hyrave, të cilat është dashur të identifikohen dhe të përmirësohen nëse Komuna do të kishte kryer harmonizime mujore në mes të Thesarit, pasqyrave bankare dhe dokumenteve burimore të saj. Diferencat me shqetësuese janë paraqitur në tabelën nr. 2.

Tabela nr.2 Të hyrat vetjake të këtyre dy drejtorive

Te hyrat për vitin 2007			
	ne €		
	Sipas Free Balance	Sipas evidencave kontabël	Diferenca
Te hyrat nga Urbanizmi	149,025	129,143	19,882
Te hyrat nga Ekonomia	1,969	10,394	(8,425)

Komenti i Komunës

Në këtë tabelë është vërejte një diferencë në mes të shënimeve të Free Balancit dhe të shënimeve të drejtorisë bazë që ka ofruar shërbime.

Të hyrat nga urbanizmi, diferenca 19,882 euro është si pasoj e mos regjistrimit të të gjitha shënimeve nga ana e drejtorisë për urbanizëm, si pasojë e ndërgjegjes së palëve të cilat pasi kanë marrë faturën për pagesë në Bankë dhe të njëjtat i kanë kryer por nuk e kanë sjell dëshminë për pagesë të bankës të zyrta adekuat dhe si pasojë e kësaj ka lind ky mosbarazim.

Konstatojmë se shënimet e zyrtarit te te hyrave komunale janë te sakta dhe te njëjta janë te bazuara ne raportet e bankës dhe të sistemit të Free Balancit. I njëjti konstatim vlen edhe për diferencën e te hyrave për drejtorinë e ekonomisë.

Me aplikimin e sistemit te ri te fletëpagesave për të hyrat vetjake (me barkod),krijohen mundësit e eliminimit te këtyre diferencave pasi qe fletëpagesa me barkod posedon kopje te mjaftueshme.

Përgjigja e ZAGJ-së ndaj komenteve

Komuna pajtohet më të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit derisa në komentet e dhëna vetëm shpjegon rrethanat të cilat kishin shkaktuar ndodhjen e mosbarazimit të identifikuar. Rrjedhimisht, çështjet faktike të kësaj të gjeture mbesin të pandryshuara.

Konkluzion

Si pasojë e mungesës së harmonizimeve ndërmjet regjistrave kontabël ndërmjet sistemit “ Free Balance” dhe komunës, diferencat nuk janë zbuluar dhe korrigjuar. Kjo ka shpie që pasqyrat

financiare të mos japin informata të sakta dhe të besueshme.

Rekomandimi 2

- Harmonizimi mujor i shënimeve të komunës dhe Thesarit duhet të kryhet dhe të zbulohen, hulumtohen dhe të korrigojnë gabimet.

3.2 Të hyrat vetjake

Një analizë e të hyrave vetjake për vitin 2007 është paraqitur më poshtë:

Tabela nr. 3

Përshkrimi i të hyrave	Fundi i vitit 31 Dhjetor 2007 (në Euro)
Tatimi për biznese Individuale	82,835
Tatimi ne Pronë	198,487
Taksë komunale për leje ndërtimi	108,640
Të hyrat nga Gjobat e Gjykatës	118,610
Të hyrat nga Gjobat ne Trafik	30.888
Totali	<u>539,460</u>

3.2.1 Tatimi për biznese individuale

Të gjeturat – shkalla e ulët e inkasimit

Vlera e përbashkët e kësaj takse komunale, e faturuar ndaj bizneseve lokale për vitin 2007 arrin vlerën prej 183,503 €, ndërsa në emër të kësaj takse Komuna kishte inkasuar vetëm 83,040 € apo 45% të totalit të faturuar. Ne konsiderojmë se kjo shkallë e inkasimit të faturave nuk është e kënaqshme dhe se tregon mos efikasitetin e mjaftueshëm të Komunës në mbledhjen e tyre.

3.2.2 Tatimi në Pronë

Të gjeturat

Dokumentacioni mbështetës për vlerësimin dhe inkasimin e tatimit në pronë nuk ka qenë i disponueshëm për inspektim për shkak të mungesës së zyrtarit përgjegjës për këto shënime.

Prandaj, ne e kemi shfrytëzuar sistemin e Thesarit si burim për vlerësimin e kësaj të hyre që është treguar më lartë në tabelën nr. 3

Konkluzion

Mungesa e dokumentacionit primar për vlerësimin dhe mbledhjen e tatimit në pronë na shpie në përfundim që vlera e raportuar në pasqyrat financiare mund të jetë e pasaktë dhe si rezultat shpie

në keqdeklarimet në pasqyrat financiare.

Rekomandimi 3

Komuna duhet të sigurojë çdo herë që i tërë dokumentacioni primar për tatimin në pronë është i disponueshëm për inspektim nga inspekcioni i auditimit.

3.2.3 Taksa komunale për leje ndërtimi

Të gjeturat

Gjatë vitit 2007, ishin lëshuar 60 leje të ndërtimit në shumë prej 108,641 €. Megjithatë, sikurse që tregon shembulli vijues, kostoja e licencave nuk është harmonizuar gjithmonë në fushën e pronës së ndërtuar.

Në ngastrën nr. 656 ishte ndërtuar një kat ose 1,111.23 metra katror pa lejen paraprake të ndërtimit. Si rezultat, komuna ka humbur një shumë prej 11.112€. Ky ndërtim pa leje është zbuluar nga komuna dhe është urdhëruar suspendimi i punës më 28.09.2007.

Në fund, ne nuk kemi mundur ta konfirmojmë që ky objekt është regjistruar në regjistrin e tatimit në pronë.

Rekomandimi 4.

- Në pajtim me Ligjin nr. 2004/15 për ndërtim dhe në rregulloret e brendshme Komunale, komuna duhet t'i kompensojë taksat e papaguara të ndërtimit të raportuar më lartë si ilegal dhe të sigurojë që hollësitë e plota të objektit janë përfshirë në shënimet përkatëse.

4. Participimet në shëndetësi

Të gjeturat

Ne raportojmë shënimet jo të plota dhe mungesën e ndarjes së detyrave në pjesën që ka të bëjë me këtë lloj të hyre.

Raporti i shënimeve të Thesarit për të hyrat tregon shumë prej 43,851.50€ për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF). Megjithatë, ne nuk kemi mundur të verifikojmë këtë shumë meqë dokumentacioni i ofruar nga QKMF-ja nuk përmbante të dhëna të plota.

Veç kësaj, kishte mungesë në ndarje të detyrave në mbledhjen e kesh-it për shërbimet e ofruara shëndetësore.

Konkluzion

Mungesa e shënimeve të plota dhe ndarja jo e duhur e detyrave na shpie në përfundimin që është e pamundur të ofrohet ndonjë siguri që pasqyrat financiare janë të sakta në raportimin dhe paraqitjen e këtij burimi të hyrave.

Rekomandimi 5

- Shënimet e duhura të kontabilitetit dhe dokumentacioni mbështetës duhet të ruhen për të mundësuar harmonizimin me shënimet e Thesarit.
- Ndarja e duhur e detyrave duhet të zbatohet gjatë procesit të ngarkimit më blloka për kontrollimin e pacienteve dhe mbledhjes së të hyrave nga këto shërbime.

5. Taksa për shkollimin joformal

Të gjeturat

Të hyrat vetjake të drejtorisë së arsimit për vitin 2007 në shumë prej 6,625€ ishin për arsimin e mesëm.

Në pjesën e parë të vitit të hyrat nga ky burim në shumë prej 3,315€ ishin mbledhur dhe deponuar në llogarinë bankare personale të drejtorit të shkollës. Kjo nuk është në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike nr. 2003/2. Në pjesën e dytë të vitit pjesa e mbetur e këtyre të hyrave është mbledhur dhe deponuar në llogarinë zyrtare bankare të shkollës.

Disa nga këto të hyra ishin shpenzuar për shpenzimet e lejuara ndërsa disa janë shfrytëzuar për financimin e shpenzimeve të palejuara.

6. Pagat dhe mëditjet

Të gjeturat

Për kategorinë e pagave dhe mëditjeve për vitin 2007 komuna kishte shpenzuar 3,766,303 € ndërsa shpenzimet e vitit 2006 ku ato ishin 3,475,607 €. Në vitin 2007, numri i punëtorëve është zvogëluar në 1553 nga 1576 sa ishte në vitin 2006.

Ne kemi testuar 14 dosje të personelit dhe kemi bërë këto vërejtje:

- 11 prej tyre nuk ishin të kompletuara, në nivelet e ndryshme, krahasuar me kërkesat e UA 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës
- Testimi i mostrës tonë të dosjes së personelit në departamentin e arsimit ka treguar që dokumentet primare dhe të kërkuara mungonin në këto dosje.

Konkluzion

Ne përfundojmë që papajtueshmëria e raportuar me UA 2003/2 mund të shpie në rrezikun e rritur të drejtimit të gabueshëm me listën e pagave.

Rekomandimi 6

Menjëherë të azhurnohen të gjitha dosjet e personelit për t'i përmbushur në tërësi kërkesat e UA 2003/2 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës.

7. Mallrat dhe shërbimet

7.1 Shpenzimet e telefonit

Të gjeturat

Shënimet financiare të komunës për vitin 2007 devijojnë nga shënimet e Thesarit për 15,892€. Tabela 4 ofron hollësitë:

Tabela nr. 4

Shpenzimet	Thesari	Komuna	Ndryshimi
	€	€	€
Fikse	20,962.28	16,119.98	4,842.3
Mobile	13,618.00	2,568.66	11,049.34
Gjithsej	34,580.28	18,688.58	15,891.64

Komuna nuk ka qenë në gjendje të ofrojë dokumentacionin për mbështetjen e shpenzimeve të raportuara të telefonit. Prandaj, ka mundësi që të dhënat e paraqitura në pasqyrat financiare të jenë të pasakta.

Ne raportojmë se kemi gjetur raste ku të punësuarit i kanë tejkaluar limitet e shpenzimeve për telefona sipas përkufizimit të:

- Nenit 10 të UA 08/2006;
- Vendimi 02. nr. 168 i datës 31. 03.2006; dhe
- Vendimi 02. nr. 210 i datës 30.03.2007.

Konkluzion

Ne përfundojmë që komuna nuk mban shënime dhe informata të sakta dhe të azhurnuara dhe se nuk janë kryer harmonizimet me shënimet e Thesarit. Këta janë treguesit e kontrolleve të dobëta dhe joefikase lidhur me këto lloje të shpenzimit. Prandaj, ka mundësi që komuna e ka ekspozuar vetën ndaj rrezikut të keqpërdorimit të telefonave dhe se të dhënat në pasqyrat financiare janë të pasakta.

Rekomandimi 7

- Kontrollat përkatëse duhet të vendosen menjëherë për të monitoruar dhe kontrolluar shpenzimet e telefonit.
- Harmonizimet mujore duhet të kryhen me shënimet e Thesarit dhe të gjitha ndryshimet të hetohen dhe korrigjohen.
- Shpenzimet e tepërta duhet të kompensohen nga ata punonjës të cilët i kanë tejkaluar limitet e shpenzimeve sipas UA 08/2006.

Komentet e Komunës

Mosbarazimi i shumave për telefonin fikse dhe mobile mes thesarit dhe komunës, e përcaktuar në tabelë sipas auditorëve nuk paraqet gjendje reale, lidhur me këtë ofrojmë tabelën e shpenzimeve të telefonisë fikse dhe vala900 sipas drejtorive përkatëse ku shihet qartë shpenzimi për secilën drejtori veç e veç.

Përgjigja e ZAGJ-së ndaj komenteve

Komuna nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për shpenzime të telefonisë fikse dhe vala 900, andaj konkluzioni dhe rekomandimi mbeten të pandryshuara.

7.2 Mirëmbajtja dhe Riparim i automjeteve

Të gjeturat

Në vitin 2007 shpenzimet për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve janë rritur për 26.817€ ose 17% nga 22.859€ sa ka qenë në vitin 2006.

Ne raportojmë që komuna nuk ka kontratë afatgjate për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve. Në vend të saj, mbështetet në kontratat individuale për çdo aktivitete të mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve.

Konkluzion

Mungesa e një kontrate vjetore për këtë aktivitet mund të rezultojë në shpenzimet shtesë si dhe në vonesat duke hyrë nëpër një numër të proceseve individuale të prokurimit.

Rekomandimi 8

- Komuna duhet ta merr parasysh lidhjen e kontratës afatgjate me një furnitor të vetëm për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve.

7.3 Shpenzimet për derivate

Të gjeturat

Për 4 muajt e parë të vitit 2007 Komuna e Vushtrrisë nuk kishte kontratë të vlefshme të furnizimit me derivate për automjete.

Konkluzion

Ne përfundojmë që blerja e derivateve për 4 muajt e parë të vitit 2007 ka qenë në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik 2003/17. Kjo ka krijuar një gjendje ku kontrollet e brendshme ishin të dobëta dhe të cilat kanë rritur mundësinë keqpërdorimit të mjeteve publike.

Rekomandimi 9

- Komuna duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me kërkesat e Ligjit për Prokurimin Publik.

7.4 Shpenzimet e sigurimit të automjeteve

Të gjeturat

Komuna nuk ka kontratë me kompaninë e sigurimeve për sigurimin e automjeteve.

Konkluzion

Ne përfundojmë që komuna i ka shkelur kërkesat e LPP-së duke mos i zbatuar procedurat tenderuese për këtë shërbim. Si rezultat, komuna e ka ekspozuar vetën ndaj rrezikut për pagesën më të madhe për këtë shërbim dhe eliminimit të konkurrencës së lirë.

Rekomandimi 10

- Komuna duhet t'i zbatojë kërkesat e LPP-së për prokurimin e të gjitha mallrave dhe shërbimeve.

7.5 Furnizime të tjera

Të gjeturat

Shënimet e Thesarit për vitin 2007 tregojnë për shumën 13,097.50€ për këtë kategori ekonomike. Auditimi ynë raporton të gjeturën vijuese:

- **Furnizim me veshmbathje dimërore për Njësinë e Zjarrfikësve, vlera 5,300 €**

Ky furnizim është arritur me një vonesë prej 33 ditësh nga afati i kontratës. Megjithatë, kontrata nuk përmban ndonjë dispozitë për zbatimin e penaleve financiare të cilat rezultojnë nga vonesat në realizmin e kontratës.

Konkluzion

